



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, - Ministarstvo za Ffinansije, Rada i Transfera- Ministry of Finance, Labour and Transfers

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT

CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

Datë:	22.11.2021
Për:	Zyra Kombëtare e Auditimit
Kopje:	Arkivit të AQP-së
Nga:	Behxhet Rrukiqi, Zv.Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Qendrore të Prokurimit
Tema	Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të auditimit me temë: Raporti i auditimit të performancës për "Kontrata e centralizuar - Shërbimet e transportit ajror"

Në pajtim me nenin 14 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, si dhe duke u mbështetur në Procedurat Standarde të Trajtitimit të Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, po ju dërgojmë Planin e veprimit për zbatimin e Rekomandimeve që dalin nga Raporti i auditimit me temën: Raporti i auditimit të performancës për "Kontrata e centralizuar - Shërbimet e transportit ajror".

PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE QË DALIN NGA RAPORTI I AUDITIMIT TË PËRFORMANCËS PËR
 “KONTRATA E CENTRALIZUAR – SHËRBIMET E TRANSPORTIT AJROR”

Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmerru	Zyrtarët përgjegjës / Departamenti	Afati
1.	Kemi bërë analize të tillë duke e ulur dukshëm vlerën e parashikuar për tarifën e shërbimit ndërsa vlera prej 400€ nuk është vlerë që ka ndikim por edhe kjo vlerë do të analizohet për procedurat e ardhshme.	Departamenti për procedura të centralizuara	Menjëherë
2.	Ky rekomandim mbulohet nga rekomandimi i auditorit për Qeverinë e Kosovës dhe në kontratën e ardhshme është shtuar tek kushtet e veçanta të kontratës : “Çdo vendimi apo miratim/ndryshimi i UA nga Qeveria e Kosovës gjatë kohëzgjatjes së kontratës që adreson çështjen e klasave të lejuara të udhëtimit në transport ajror për zyrtaret publik duhet të respektohet nga të gjitha palët që shfrytëzojnë këtë kontratë.”	Departamenti për procedura të centralizuara	Menjëherë
3.	Në procedurën për kontratën e ardhshme është larguar kërkesa për punëtorë, kjo para pranimit të raportit të auditimit por edhe në të ardhmen do të vlerësohen të gjitha kërkesat.	Departamenti për procedura të centralizuara	Menjëherë
4.	E drejta për ankesa edhe ne minitender është problem për realizimin e kësaj kontrate me këtë lloj të procedurës, ndryshimet ligjore në LPP mund të mundësojnë përdorimin e kësaj procedure në të ardhmen, gjithashtu duke pasur parasysh që çmimet e biletave janë momentale përdorimi i kësaj procedure do të jetë problem por gjithsesi AQP do e shtrojë si temë diskutimi për procedurat e ardhshme për shërbimet e transportit ajror.	Departamenti për procedura të centralizuara	Menjëherë